



VENDIM

Nr. 45, Datë 16.06.2014

**PËR
AUTORIZIMIN E ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË
SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 Janar 2013 “Për heqjen e licencave të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 08, datë 25.01.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike” të miratuar me Vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 09, datë 25.01.2008, të ndryshuar”, Vendimit nr. 5, datë 21.01.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për vendosjen e shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013, “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, Vendimit nr. 118, datë 18.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për emërimin e administratorit të përkohshëm të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A” si dhe nenit 11, pika 1 e Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të Ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës ..2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dërguar me shkresën nr. 3704, datë 13.6.2014” Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë CEZ a.s”,

Vendosi :

1. Autorizohet Z. Arben Seferi, administrator i përkohshëm i shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, që të marrë pjesë në procesin e finalizimit të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s;
2. Në rast të arritjes së një marrëveshjeje, autorizohet Z. Seferi, që të nënshkruajë marrëveshjen dhe cdo instrument që i bashkëlidhet asaj, në emër të shoqërisë CEZ Shpërndarje (në administrim të përkohshëm).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Petrit AHMETI